



Dr.Suat Yëlldërëm

Shkaqet e konfuzionit rreth  
**PËRKTHIMIT TË  
DOMËTHËNIEVE  
TË AJETEVE TË  
KURA'NIT FISNIK**



Prof.Dr.Suat Yëlldërëm

**SHKAQET E KONFUZIONIT RRETH  
PËRKTHIMIT TË DOMETHËNIEVE  
TË AJETEVE TË KUR'ANIT FISNIK**

Përktheu:

Sedat ISLAMI

Recensent: Ajni Sinani

Redaktore gjuhësore: Mimoza Sinani

Per botuesin:

Doc.prof.Dr.Hfz.Hajredin Hoxha(ish studenti i Autorit)

## Hyrje

Falënderimet i takojnë Allahut të Madhëruar! Përshëndetjet tona qofshin mbi zotërinë e njerëzimit, Muhammedin, familjen, shokët dhe të gjithë ata që pasojnë rrugën e tij deri në amshim!

Misioni i Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] është mision i përmasave universale, i cili i drejtohet të gjithë njerëzve dhe vlen deri në mbarim të kësaj bote. Kjo është përmendur shumë qartë në disa ajete kur'anore, si:

*"Ne nuk të dërguam ty ndryshe vetëm se për të gjithë njerëzit, myzhdedhënës dhe tërheqës i vërejtjes, por shumica e njerëzve nuk e dinë."* (Sebe', 28)

*Thuaj (Muhammed): "O ju njerëz! Unë jam i dërguari i All-llahut te të gjithë ju. All-llahut që vetëm i Tij është sundimi i qiejve e i tokës, s'ka të adhuroar tjetër pos Tij; Ai jep jetë dhe Ai jep vdekje, pra besoni All-llahun dhe të dërguarin e Tij, pejgamberin e pashkolluar, që beson All-llahun dhe shpalljet e Tij, ndiqeni rrugën e tij që ta gjeni të vërtetën."* (el-A'rafë, 158)

*"E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat."* (el-Enbija, 107)

Këto dhe ajete tjera përcaktojnë kumtimin e misionit kur'anor tek të gjithë njerëzimi. Por, ka dhe ajete të tjera që obligojnë përkthimin e domethëniesve të ajeteve kur'anore:

*"Ne ua bëmë të lehtë atë (Kur'anin) në gjuhën tënde, ashtu që ata të marrin mësim."* (ed-Duhan, 58)

*"Sikur Ne ta bënim Kur'anin në gjuhë të huaj, ata do të thoshin: "Përse nuk janë ajetet e tij të kuptueshme (të shkoqitura), a është ai (Kur'ani) në gjuhë të huaj, kurse ai (pejgamberi) është arab?" Thuaj: "Ai është për besimtarët udhëzues e shërues. E ata që nuk besojnë, në veshët e tyre kanë shurdhim, dhe ai për ta është verbërim. Të tillët janë sikurse thirren prej një vendi të largët e nuk dëgjojnë"."* (Fussilet, 44)

Këto dy ajete merren bazë për obligimin e përkthimit të domethëniesve të ajeteve kur'anore, ngase, përderisa Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] është i dërguar tek të gjithë njerëzimi, pra arabët dhe joarabët, atëherë nuk



ka kuptim që atyre t'iu shpallet një libër që nuk e kuptojnë<sup>1</sup>. Allahu i Madhëruar ka thënë:

*“Ne asnjë nga të dërguarit nuk e dërguam ndryshe vetëm në gjuhën e popullit të vet...”* (Ibrahim, 4)

Bejdaviu, në komentimin e këtij ajeti, ka thënë: *‘Janë urdhëruar që ta kuptojnë atë me lehtësi dhe shpejtësi, e më pastaj t’ua bartin të tjerëve dhe t’ua përkthejnë atyre...’*

Po kështu, Allahu i Madhëruar ka thënë:

*“E nëse ndokush prej idhujtarëve të kërkon strehim, ti strehoje në mënyrë që t’i dëgjojë fjalët e All-llahut (Kur’anin), e mandej përcille deri në vendin e tij të sigurt...”* (et-Teube, 6)

Idhujtari joarab nuk ka mundësi ta dëgjojë apo kuptojë Kur’anin përveçse nëpërmjet përkthimit të domethënieve të tij. Shumë dijetarë, si: Ebu Hanife, Ebu Jusufi, Muhammed Shejbani, Xhessasi, Gazaliu, Shatibiu<sup>2</sup> etj, nga ky ajet dhe ajete të ngjashme kanë nxjerrë dispozitën e lejimit të përkthimit të domethënieve të ajeteve kur’anore, me qëllimin e kumtimit të tyre në gjuhë të ndryshme<sup>3</sup>.

Kur’ani Famëlartë zotëron domethënie bazike, në kuptimin e të cilave janë të barabartë të gjithë ata që i dinë kuptimet e fjalëve si fjalë të thjeshta dhe fjalëve kur janë si të përbëra. Por, gjithsesi ka edhe fjalë të tjera që kanë kuptime sekondare apo dytësore, e me të cilat synohen ato forma dhe mënyra që e ngrenë të folurit e Kur’anit në pozitën e të qenit sfidues (mu’xhiz). Me këtë rast, do të bënim mirë që të mos harrojmë se lejimi i përkthimit të kuptimeve kur’anore, nga dijetarët që zumë në gojë më lart, ka të bëjë pikërisht me domethëniet bazike. Ndryshe, nuk ka gjuhë në botë që mund t’i përgjigjet gjuhës arabe në kuptimet e shprehjeve dhe fraza të saj, të cilat dijetarët i quajnë ‘Havasut-terakib’ (karakteret apo atributet e strukturave të fjalëve).

---

<sup>1</sup> Ibnul Hatib, El-Furkan, f. 173.

<sup>2</sup> Shih: *El-Mebsut* të Serhasiut 1/37; *El-Hidaje* të Merganit 1/47; *Ahkam el-Kur’an* të Xhessasit 5/262; *el-Mustasfa min Ilmil Usul* 1/199; *el-Muwaafekat* të Shatibiut 2/44-45; *Bedaiu-s-Sanaïë* të Kasanit 1/112; *Mebahith fi Ulumul Kur’an* të Mennaë Kattanit f. 317; *el-Feuzul kebir fi Usulit Tefsir* të Dehlavit, f. 97; *Menahil el urfan* të Zerkanit, 2/162.

<sup>3</sup> Rreth përkthimit të Kur’anit Fisnik në gjuhën turke, shih: *Hidajet Ajdar*, Istanbul, 1996, f. 177-213.

Megjithëkëtë, edhe kur bëhet fjalë për përkthimin e domethënieve bazike, ndodhin gabime, për shkak se një fjalë në Kur'an mund të ketë më shumë se një kuptim, kështu që përkthyesi mund ta vërë shprehjen që mendon, për shkak të mungesës së një shprehje adekuate nga gjuha e tij amtare që do të mund të bartte më shumë se një kuptim<sup>4</sup>.

Përkthimi do të llogaritej i suksesshëm atëherë kur përkthyesi do të arrinte që t'i sillte domethëniet dhe kuptimet plotësisht, pa mangësi, ndërsa, në rast se do të ndodhte që në tekstin kryesor të mos figuronte ndonjë prej objektivave bazë, atëherë do të konstatojmë se përkthimi është i mangët dhe rrjedhimisht i papranueshëm. Kjo ngase ai përkthim do të mund të shkaktonte dëme të mëdha, sidomos nëse teksti ka të bëjë me diç të rëndësishme dhe me peshë në fe dhe, në këtë rast, përgjegjësia e këtyre gabimeve bie mbi supet e përkthyesit<sup>5</sup> dhe askujt tjetër.

Në vijim, do të paraqesim shkaqet kryesore që shkaktojnë paqartësi dhe probleme rreth përkthimit të Kur'anit Famëlartë.

---

<sup>4</sup> Kattan, Mennaë, *Mebahith fi Ulumil Kur'an*, f. 315.

<sup>5</sup> Aydin, Ferit, *Tercume Sanatinin Gercekleri*, Istanbul, 1984, f. 130-131.

## 1. DUKURIA E SHPREHJEVE METAFORIKE NË KUR'ANIN FISNIK

Shprehjet linguistike (ar. *el-hakika*) janë shprehjet që në esencë janë vënë për kuptime jometaforike, pra janë të drejtpërdrejta, derisa ato metaforike (*el-mexhaz*) janë vënë që domethëniet e vërteta të mos jenë ata që figurojnë sipërfaqësisht, dhe kjo për shkak të raporteve që ka ndërmjet domethënies bazike dhe domethënies për të cilën është përdorur, kuptohet me dëshmi që flet se nuk synohet domethënia bazike (apo sipërfaqësore).

Disa dijetarë thonë se në Kur'an nuk ka shprehje metaforike për shkak se, siç thonë ata, metaforikja është simotër me gënjeshtren dhe se folësi (*el-mutekel-lim*) nuk e praktikon atë përveçse kur i vështirësohet kuptimi i drejtpërdrejtë, e kjo është e papranueshme që të thuhet në kontekst me Allahun.

Por, jo të gjithë ndajnë me ta këtë mendim. Ata që e kanë shijuar ëmbëlsinë e stilit kur'anor thonë se dyshimi është i kotë, për shkak se po t'i mungonte metafora Kur'anit, do t'i mungonte gjysma e bukurisë së tij. Gjuhëtarët janë unikë sa i përket asaj se metafora është më kuptimplote se shprehjet linguistike. Sikur të supozohej se Kur'anit duhet t'i hiqen metaforat, atëherë kjo do t'i binte që Kur'anit t'i hiqet '*hadhfi*' (shkurtimi), '*tevkidi*' (përforcimi), kualiteti i tregimeve etj.

Ajo që e vështirëson punën e përkthimit janë pikërisht shprehjet e shumta metaforike që gjenden në Kur'an. Ndodh që përkthyesi ta përkthejë shprehjen metaforike si shprehje linguistike dhe kështu të bjerë në gabim, si p.sh. në rastet në vijim:

1) Allahu i Madhëruar thotë:

*"... E, sikur t'i shihje mizorët kur janë në agoni të vdekjes, e engjëjt kanë shtrirë duart e veta (me ndëshkim) e (u thonë): "Shpëtojeni pra vetveten (nëse mundeni)". "Tash përjetoni dënimin e turpshëm për shkak se e thoshit të pavërtetën për All-llahun, dhe ndaj argumenteve të Tij ishit kryeneçë". (el-En'amë, 93)*

Fjala 'agoni' në origjinal ka ardhur si 'gamerat', që ka kuptimin e mbulimit nga uji (fundosjes), duke mos i lënë njeriut asnjë mundësi shpëtimi. Është përhapur përdorimi i saj me kuptimin e vështirësisë si ngjasim me

gjendjen e të fundosurit, derisa ta mbulojë rrjedha apo uji. Ndërsa fjala e melaikeve *'nxirreni veten'* (ar. ahrixhu enfusekum) ka kuptimin e shpëtimit nga marrja e shpirtit. Kështu, përdorimi i shprehjes *'gamerat'* është metaforik, ndërsa i vdekjes *'el-meot'* është lingvistik – i vërtetë, kurse *'shtrirja e dorës'* ka kuptimin e vështirësisë së nxjerrjes së shpirtit, ndryshe, s'ka shtrirje dhe as duar<sup>6</sup>.

2) Ajeti 16 nga kaptina el-Bekare. Allahu i Madhëruar thotë:

*"Të tillët janë që e ndërruan të vërtetën (besimin) me të pavërtetën (mosbesimin), pra tregtia e tyre nuk pati fitim dhe ata nuk qenë të vetëdijshëm (në punën e tyre)."*

Nesefiu<sup>7</sup> ka thënë: *'Atribuimi i fitimit të tregtisë është vetëm nga aspekti metaforik. Domethënia është se nuk fituan në tregtinë e tyre, ndryshe tregtia nuk fiton, por meqë ndodhi blerja e së kotës dhe devijimit me udhëzim në mënyrë alegorike, atëherë u përmendën fitimi dhe tregtia si sqarim përkatës.'*

3) Ajeti 14 nga kaptina err-Rra'd. Allahu i Lartësuar thotë:

*"Lutje e vërtetë është vetëm ajo drejtuar Atij, e ata që u luten të tjerëve pos Tij, ata nuk u përgjigjen atyre asgjë tjetër, (gjendja e tyre është) vetëm si e atij që shtrin duart (prej së largu) nga uji, që ai (uji) t'i arrijë deri në gojën e tij, por (uji) nuk do t'i arrijë (sepse uji është send i vdekur e nuk kupton për etjen e tij). E lutja e jobesimtarëve (drejtuar pos Zotit) nuk është tjetër vetëm se dështim (kotësi)."*

Ibni Ashuri ka thënë: *'Qëllimi me 'shtrin duart' është kur njeriu mbush ujë por me grushte të hapura, në të cilat uji nuk mund të qëndrojë. Kjo është sikur ajo fjala që thuhet 'mban ujin me dorë' kur flitet për atë që është i shkujdesur dhe humb pasurinë... Në fakt, këto fjalë janë përngjasim, ngase gjendjen e idhujtarëve të cilët lusin idhujt dhe kërkojnë të mira prej tyre ndërsa ata nuk iu përgjigjen fare atyre, e ngjason me gjendjen e një të eturi, i cili shtrin duart e tij nga uji për të pirë ujë por nuk mund ta realizojë dot një gjë të tillë dhe munda i tij shkon huq. Pra, është thjesht një metaforë...'*<sup>8</sup>

4) Ajeti 64 nga kaptina el-Maide. Allahu i Madhëruar thotë:

*"Jehuditë thanë: "Dora e All-llahut është e shtrënguar!" Qofshin të shtangura duart e tyre dhe qofshin të mallkuar, pse thanë atë. Jo, duart e*

<sup>6</sup> Ibni Ashur, *et-Tahrir ve-t-tenvir*, 7/377-387.

<sup>7</sup> Shih: *Medarik et-Tenzil*, f. 26.

<sup>8</sup> Ibni Ashur, *et-Tahrir ve-t-tenvir*, 7/109; Zerkan, *Menahil el urfan*, 2/112.



*Tij janë të shkira. Ai furnizon ashtu si të dojë. Kjo që t'u zbrit ty do t'u shtojë disave nga ata (nga paria fetare) shumë largimin dhe mohimin. Ne ndërmjet tyre hodhëm armiçësi dhe urrejtje që do t'u vazhdojë deri në ditën e kiametit. Sa herë që ndezën zjarr për luftë, All-llahu e shoi atë, e ata përpigën për shkatërrime në tokë. All-llahu nuk i do ngatërrestarët."*

Ibni Ashuri ka thënë edhe këtë: 'Domethënia e (pjesës së ajetit, në të cilën çifutët akuzuan Zotin se) 'Dora e Zotit është e shtrënguar' (jedullahi magluletun) është përshkrim i koprracisë me dhënie ngase arabët për dhënie shprehen me 'dorë'; shtrirja e dorës është për bujari e fisnikëri, ndërsa shtrëngimi i dorës për koprraci. Nuk e kemi dëgjuar më parë fjalën 'gal-le jedehu' përveçse në Kur'an, siç është këtu.'<sup>9</sup>

5) Ajeti 29 nga kaptina el-Isra, në të cilin Allahu i Madhëruar thotë:

*Dhe mos e bën dorën tënde të lidhur për qafe (mos u bë koprrac), e as mos e shtrij në tërësi, e të mbetesh i qortuar dhe duarthatë (nga shpenzimi i tepërt)."*

Ibni Ashuri, në komentimin e këtij ajeti, thotë: 'Sa i përket retorikës këtu, ajo shprehet duke parafrazuar koprracinë dhe mosdhënien me lidhjen e dorës në qafë. Është një shembull i ndërtuar mbi imagjinimin e dorës si burim i shpenzimit dhe dhënies...

Është një imagjinatë e njohur tek oratorët dhe poetët. Përdoret edhe në gjuhën e popullit: 'Ka dorë në filanin' (lehu jedun ala fulan) me kuptimin e ndihmës që i ka bërë atij. Ajeti e sjell koprracinë në shembullin e dorës së lidhur për qafe e cila nuk mund të lëvizë dhe rrjedhimisht nuk prej saj ka dobi. Por, edhe dora që nuk është nën kontroll, por vetëm lëviz, nuk është e mirë...'

---

<sup>9</sup> Ibni Ashur, *et-Tahrir ve-t-tenvir*, 4/249.

## 2. DUKURIA E HADHFIT - SHKURTIMIT NË KUR'AN

Shkurtimi (ar. *el-hadhfu*) nënkupton, që për shkak të ndonjë argumenti, ta fshehë një pjesë apo tërë të folurit. Në Kur'an përdoret shpesh, madje në forma të ndryshme. Do të paraqiste problem shumë serioz për përkthyesin fakti nëse ai nuk do të ishte në gjendje ta dallonte këtë gjë në Kur'an. Ja disa shembuj:

1) Fshirja e përgjigjes së betimit, për shkak të dijes së dëgjuesit për qëllimin e tij (betimit). P.sh. Allahu thotë:

*"Pasha ata (engjëj) që marrin shpirtrat me rrëmbim (përmbytshëm)! 2. Dhe ata që marrin shpirtra me lehtësim! 3. Dhe ata që notojnë me shpejtësi! 4. Dhe nxitësit të cilët me shpejtësi në vendin e vet i çojnë! 5. Dhe pasha ata që çdo çështje rregullojnë! 6. Ditën që vrullshëm bëhet dridhja."* (en-Naziat, 1-6)

Shumë nga përkthyesit mjaftohen vetëm me përkthimin e këtyre shprehjeve të ardhura në këto betime të Allahut, ndërsa lexuesi nuk e kupton qëllimin nga betimet, kështu që mbetet në një gjendje konfuzioni e paqartësie. Përkthyesi patjetër se do të duhej që të hidhte në letër edhe atë që paramendohet: *'Do të ringjallen dhe do të llogariteni'*, për shkak se, siç dëshmohet në po këtë kaptinë, ata e mohonin ringjalljen. Allahu e përshekruan këtë besim të tyre me vetë gojët e tyre:

*"Ata (idhujtarët në dynja) thonë: "A thua do të bëhemi përsëri kështu si jemi?"* (en-Naziat, 10)

2) Fshirja e fjalisë, sikurse në ajetin kur'anor:

*"Atij që All-llahu ia ka zgjeruar kraharorin për besimin islam, ai është në një dritë të sigurt prej Zotit të vet. Të mjerë janë ata që nga zemërfortësia e tyre nuk e përmendin All-llahun, të tillët janë në humbje të qartë."* (ez-Zumer, 22)

Pjesa e ajetit *'Të mjerë janë ata që nga zemërfortësia e tyre nuk e përmendin All-llahun'* nënkupton se bëhet fjalë për fshirje fjalie pasi që besimtarët nuk krahasohen me ata që kanë zemra të vrazhda dhe janë lënë ashtu në padrejtësinë e tyre shpirtërore dhe në kufrin e tyre. Pra, në vend se të përmendet kjo, është përmendur vetëm pjesa që figuron.

Ngjashëm me këtë është edhe ajeti:

*“...a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?...”* (el-Huxhurat, 12)

Farisiu ka thënë: Pra, ashtu siç e urreni këtë, urrejeni dhe përgojimin. Ndërsa pjesa e ajetit në vazhdim: *dhe t'ia keni frikën'* është lidhje (ar. *el-atfu*) me fjalën paraprake '*Atë pra e urreni!*' edhe nëse është përmendur për shkak të aludimit të të folurit për të. Kjo është e ngjashme me fjalën:

*...gufuan...'*<sup>10</sup>,

që ka domethënien se ai (Musa *alejhis selam* ) e goditi tokën me shkop ndërsa krojet gufuan. Pra, pjesa e ajetit:

*Atë pra e urreni!*

është rifillim (ar. *muste'nef*) nga fjalia paraprake, ndërsa pjesëza 'f' (ar. ف) ka ardhur për shkak se të folurit është në kuptimin e përgjigjes. Allahu sikur po i pyet:

*...a mos ndonjëri prej jush dëshiron'*

ndërsa ata i thonë 'jo', dhe Ai shton

*Atë pra e urreni!*

Pra, ashtu siç urreni këtë, urrejeni edhe përgojimin<sup>11</sup>.

I këtillë është edhe ajeti 171 nga kaptina el-Bekare, në të cilin Allahu i Madhëruar thotë:

*“Shembulli i (i thirrësit të) atyre që nuk besuan është sikurse i atij (bariut) që u lëshon britmë atyre (bagëtive) që nuk dëgjojnë tjetër vetëm se britmë e zë (e nuk kuptojnë). Ata janë të shurdhër, memecë e të verbër, ata nuk kuptojnë.”*

Imam Taberiu, duke komentuar këtë ajet, thotë: 'Komentimin që e shoh si parësor është ai që ka dhënë Ibni Abbasi dhe ata që pajtohen me të, e i cili është: Shembulli i këshillimit të jobesimtarëve dhe këshilluesit të tyre është sikurse shembulli i bariut që thërret bagëtinë e tij ndërsa ato nuk kuptojnë asgjë nga të folurit e tij. Sa i përket lejimit të shkurtimit apo fshirjes së fjalës 'këshilloi', kjo është bërë për shkak të mjaftimit me shembullin e sjellë... E kemi zgjedhur këtë koment për shkak se ky ajet ka zbritur për çifutët dhe argumenti ynë, nëse dikujt i

<sup>10</sup> El-Bekare, 60.

<sup>11</sup> El Burhan të Zerkeshiut, 3/116.

intereson, janë ajetet paraprake dhe ato pasuese që flasin për këtë. Kësisoj, ajetet e ndërmjetme është më parësore të jenë kallëzues për ta se për tjerët, përderisa nuk ka argument që flet se kallëzuesi bartet tek të tjerët...'<sup>12</sup>

I kësaj natyre është edhe ajeti 57 nga kaptina Hud, në të cilin thuhet:

*“Nëse kundërshtoni, unë ju kumtova atë me të cilën jam dërguar te ju...”*

‘Kumtimi’ nuk është si përgjigje, për shkak se ka ardhur para fjalëve të tyre. Në fakt, këtu ka fjalë që paramendohen , e që janë: ‘Nëse ata ta kthejnë shpinën, atëherë unë nuk qortohem ngase unë ua kam kumtuar.’

Kështu është puna edhe me ajetin 38 nga kaptina el-Enfalë:

*“...po nëse vazhdojnë, ligji (i Zotit) i zbatuar ndaj të parëve është i ditur (edhe juve do t'ju zërë).”*

Domethënia është: Do t'i godasë dënimi që goditi të parët e tyre.

Ngjashëm, pra në këtë formë, është komentuar edhe ajeti 58 nga e njëjta kaptinë:

*“Nëse ti e heton tradhtinë e një populli (ndaj marrëveshjes), atëherë edhe ti ua hidh atyre (marrëveshjen) në mënyrë të njëjtë, sepse All-llahu nuk i do ata që tradhtojnë (fshehurazi).”*

Ajeti është komentuar kështu: ‘Nëse ti, Muhammed, je në dijeni për tradhtinë e një populli, me të cilin keni armëpushim apo paqe, atëherë hidhe dhe gjuaje marrëveshjen e tyre ashtu siç bënë ata. Në fakt, kjo nënkupton që ti t'i lajmërosh ata për prishjen e marrëveshjes para luftës, që të mos keqkuptohesh sikur ti e ke nisur luftën duke e thyer marrëveshjen...’<sup>13</sup>

3) Fshirja e emrit të varur (ar. *el-mudaf*) dhe vendosja e emrit bosht (ar. *el-mudaf ilejhi*) në vend të tij.

Sujuti, në veprën e tij *el-Itkan*, thotë: Fshirja e emrit të varur (ar. *el-mudaf*) në Kur'an ndodh shpesh, madje disa, si Ibni Xhinnijji, numërojnë më shumë se njëmijë raste, të cilat i ka përmendur Izzuddini në librin e tij ‘*El-Mexhaz ala tertibi-s-suver vel ajat...*’<sup>14</sup>

Ja shembuj të kësaj natyre:

---

<sup>12</sup> Tefsiru-t-Taberijj, 2/49.

<sup>13</sup> Tefsire l-Hazin, 3/60.

<sup>14</sup> El-Itkan fi Ulumul Kur'an, 2/80.

Ajeti 93 nga kaptina el-Bekare:

*"...adhurimi ndaj viçit ishte përzier me gjak në zemrat e tyre..."*

Në komentimin e këtij ajeti, siç sqaron Ragibi në el-Mufredat, f. 258, është thënë: *'Viçi është përmendur për shkak të dashurisë ekstreme ndaj tij, aq sa imazhi i tij është mishëruar me zemrat e tyre dhe nuk fshihet dot...'*<sup>15</sup>

Ajeti 102 nga kaptina el-Maide:

*"Një popull që ishte para jush pat bërë aso pyetjesh, e pastaj (nuk i zbatoi) u bë mohues i tyre."*

Ata nuk u bënë mohues për shkak të pyetjes, por për shkak të mohimit të Zotit të pyetur. Kështu, për shkak se pyetja ishte shkak i mohimit, atëherë edhe iu atribuua mohimi (pabesimi) asaj...<sup>16</sup>

Ajeti 75 nga kaptina el-Isra:

*"E atëherë Ne do ta shijonim mundimin dyfish të kësaj jete dhe dyfish të jetës tjetër..."*

Qëllimi është dyfishi i dënimit të jetës dhe vdekjes.

Ajeti 177 nga kaptina el-Bekare:

*"Nuk është tërë e mira (e kufizuar) t'i ktheni fytyrat tuaja nga lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson All-llahut, ditës së gjykimit, engjëjve, librit, pejgamberëve dhe pasurinë që e do ua jep të afërmve, bonjakëve, të varfërve, udhëtarëve, lypësve dhe (për lirim të) robërve..."*

Në ajet është përmendur fjala *'robër'* ndërsa për qëllim (ashtu siç edhe e ka përkthyer Sherif Ahmeti. përk.) është lirim i robërve, pra jo dhënia e drejtpërdrejtë e parave atyre.<sup>17</sup>

4) Fshirja e emrit të varur (ar. *el-mudaf*) dhe e emrit bosht (ar. *el-mudaf ilejhi*)

Ndodh që emri i varur (ar. *el-mudaf*) t'i shtohet një emri të varur (ar. *el-mudaf*) dhe të fshihen që të dy ndërsa të mbetet i treti. Shembuj të kësaj natyre kemi disa nga ajetet në vijim:

---

<sup>15</sup> *El-Burhan* të Zerkeshiut, 3/148.

<sup>16</sup> *Ibid.*

<sup>17</sup> *El-Itkan fi Ulumil Kur'an*, 2/80.

Ajeti 82 nga kaptina el-Vakiah:

*Dhe falënderimin për furnizimin tuaj, ju jeni që e gënjeni."*

Pra, në vend se të falënderoni për furnizimin tuaj...<sup>18</sup>

Ajeti 32 nga kaptina el-Haxh:

*"Kjo është kështu! E kush madhëron dispozitat e All-llahut, ajo është shenjë e devotshmërisë së zemrave."*

Pra kjo është vepër e atyre që kanë zemra të devotshme.

Ajeti 7 nga kaptina el-Hashr:

*Atë që All-llahu nga banorët e vendeve (jobesimtare) ia dha pa luftë të dërguarit të vet..."*

Në ajet, ashtu siç e ka vënë brenda kllapave Sherif Ahmeti, synohen vendet jobesimtare.<sup>19</sup>

5) Fshirja e përgjigjes së foljes, siç është në ajetin 36 të kaptinës el-Furkan:

*U thamë: "Shkoni ju të dy tek ai popull që i përgënjeshtroi argumentet Tona!" E Ne pastaj i shkatërruam ata shumë keq."*

Këtu, ndërmjet '*...argumentet Tona...*' dhe '*Ne pastaj...*' paramendohet fjalia foljore: '*...ata shkuan por i përgënjeshtroan kështu...*'

I këtillë është edhe ajeti 15 nga kaptina en-Neml:

*Ne i patëm dhënë Davudit dhe Sulejmanit dituri, e ata të dy thanë: "I falënderohemi vetëm All-llahut që na dalloi (me të mira) mbi shumë robër të Tij besimtarë."*

Ajo që paramendohet këtu, ndërmjet '*...Sulejmanit dituri...*' dhe '*:I falënderohemi...*' është: '*Ata vepruan sipas saj dhe ishin të vetëdijsëm për të drejtën e mirësisë dhe nderit që iu ishte bërë, andaj edhe thanë:...*'<sup>20</sup>

---

<sup>18</sup> El-Burhan, 3

<sup>19</sup> Ibid.

<sup>20</sup> El-Kesh-shaf të Zemahsheriut, 3/278.



### 3. DUKURIA E IXHAZIT APO PËRMBLEDHJES

Ixhazi apo përmbledhja (ar. الإيجاز ) është një nga format e hadhfit (shkurtimit) dhe quhet ixhazul aksri (ar. إيجاز القصر).

Ixhazi është dy lloje:

1) Ixhaz i shprehjeve (وجيز بلفظ), i cili nënkupton që shprehja, në raport me domethënien, të jetë më e shkurtër se zakonisht. Kjo nënkupton pasurinë gjuhësore dhe retorikën e fortë. Pejgamberi Muhammed [*alejhis salatu ves selam*] ka thënë:

*"Më janë dhënë shprehjet përmbledhëse!"*

Ajete me këtë kuptim ka shumë. P.sh.: ajeti 179 nga kaptina el-Bekare:

*"O ju të zotët e mendjes, kjo masë e dënimit është jetë për ju, ashtu që të ruheni (nga mbytja e njëri-tjetrit)."*

Domethënia e këtij ajeti është e gjerë, edhe pse tekstualisht është i shkurtër.<sup>21</sup>

Shumë komentues të Kur'anit përmendin lloje të ndryshme të përmbledhjes (ixhazit) që ka bërë ky ajet.

I këtu është edhe ajeti 18 nga kaptina en-Neml:

*...një buburrec tha: "O ju buburreca, hyni në vendet tuaja..."*

Ky ajet (edhe pjesa që nuk figuron në tekst këtu) ka përfshirë 11 lloje të të folurit: thirrje, nofkë, vëmendje, emërtim, urdhërim, gjykim, qortim (vërejtje), veçim, përgjithësim, aludim, arsyetim (justifikim). Ja më qartë:

Ajeti:

*..."O ju buburreca, hyni në vendet tuaja që të mos u copëtojë Sulejmani dhe ushtria e tij duke mos ju vërejtur."*

1. Pjesët e të folurit që ka përfshirë<sup>22</sup>:

<sup>21</sup> El-Burhan, 3/228.

Nr.	Pjesa apo gjymtyra e të folurit	Pjesa e ajetit
1)	Thirrje	<i>O</i>
2)	Nofkë	<i>ju</i>
3)	Në arabisht, është edhe prapashtesa 'ha', që është për vëmendje.	<i>ju</i>
4)	Emërtim	<i>buburreca</i>
5)	Urdhër	<i>hyjni</i>
6)	Gjykim	<i>Vendet tuaja</i>
7)	Qortim – vërejtje	<i>të mos u copëtojë</i>
8)	Veçim	<i>Sulejmani</i>
9)	Përgjithësim	<i>ushtria</i>
10)	Aludim. Në arabisht është edhe përemri 've hum' që i bie 'dhe ata...'	<i>mos ju</i>
11)	Arsyetim	<i>mos ju vërejtur</i>

2. Ajeti po kështu ka përfshirë edhe pesë lloj obligimesh që ka çuar në vend buburreci, e të cilat janë si më poshtë<sup>23</sup>:

Nr.	E drejta	Përshkrimi
1)	Obligimi ndaj Allahut	Obligimin e marrë për mbikëqyrje të buburrecave e çoi në vend.
2)	Obligimi ndaj të Dërguarit të Allahut	E alarmoi Sulejmanin [ <i>alejhis selam</i> ] rreth buburrecave.
3)	Obligimi ndaj vetes	E çoi në vend obligimin e marrë nga Allahu për këshillimin e atyre që i ka nën mbikëqyrje.
4)	Obligimi ndaj buburrecave	I këshilloi ata të hyjnë në vendbanimet e tyre që të mos mbyten prej ushtrisë, e cila nuk i vëren fare.
5)	Obligimi ndaj ushtrisë së Sulejmanit [ <i>alejhis selam</i> ]	Lajmërimi i tyre se kushdo që merr përsipër kryesimin e një populli a

<sup>22</sup> Shih: Imam Zerkeshiu, *el-Burhan fi ulumi-l-Kur'an*, 3/227.

<sup>23</sup> Shih: Imam Sujuti, *Mu'treku-l-akran fi xhazi-l-Kur'an*, 1/226.

		grupi, duhet t'i këshillojë ata, të kujdeset për ta dhe t'i ruajë ata. Kjo hyn në kuadër të hadithit: <i>'Të gjithë ju jeni barinj dhe të gjithë do të llogariteni për kopenë tuaj!'</i>
--	--	--

Madhështore kështu është edhe kaptina el-Ihlas, e cila përkundër faktit se është shumë e shkurtër, është përplot margaritarë.

*"Thuaj: Ai, All-llahu është Një! 2. All-llahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. 3. As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur. 4. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë."*

Në këto ajete:

- Janë gjashtë fjali, tri prej të cilave janë afirmative ndërsa tri të tjera mohuese.
- Vërtetohen tri llojet e monoteizmit, ndërsa zhvleftësohen gjashtë lloje të idhujtarisë
- Secila fjali është argument për tjetrën, sikurse që është rezultat i saj. Kjo për shkak se është rezultat për fjalinë paraprake, ndërsa është argument për atë vijuese.

Kaptina el-Ihlas është një kaptinë që pothuajse ka përfshirë në vete 30 kaptina sikurse ajo vetë: është kaptinë e konsoliduar dhe e përbërë nga dëshmi që flasin për njëra-tjetrën. Sa për ilustrim:

*'Thuaj: Ai, All-llahu' është Një, është Samed - çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë; As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur, dhe askush nuk i është i barabartë me Të."*

#### **4. DUKURIA E I'RABIT - LAKIMIT (PIKËSIMIT DHE VOKALIZIMIT) NË GJUHËN ARABE**

Gjuha arabe është gjuhë që lakohet dhe, në të shumtën e rasteve, lakimet vijnë me domethënie të reja, që ndërrojnë varësisht lakimit. Kjo dukuri i mungon shumë gjuhëve të botës. E, nëse ndodh që përkthimi të fokusohet vetëm në një formë lakimi, atëherë ai i pamundëson format e tjera dhe rrjedhimisht do të humbasin edhe domethëniet e tjera. P.sh. ajeti 50 nga kaptina el-En'amë:

*Thuaj: "Unë nuk u them juve se i kam në kompetencë depot e All-llahut (e t'ju sjell mrekulli), as nuk pretendoj se i di fshehtësitë (e t'ju tregoj se kur do t'ju vijë dënimi), as nuk u them se unë jam engjell..."*

Shumë përkthyes fjalinë:

*'...as nuk pretendoj se i di fshehtësitë'*

E përkthejnë si fjali lidhëse me atë vijuese, dhe që i bie se 'unë nuk e di të fshehtën', ndërsa në fakt, kjo fjali është *ma'tuf* (e lidhur nëpërmjet pjesëzës) e fjalisë paraprake, e që përfundimisht i bie (ashtu siç e ka përkthyer Sherif Ahmeti. përk.): 'nuk pretendoj...' <sup>24</sup>

Ajeti 7 nga kaptina Ali Imran:

*"... Po, pos All-llahut askush nuk e di domethënien e tyre të saktë. Dijetarët e pajisur me dituri thonë: "Ne u kemi besuar atij (atyre që janë të paqarta), të gjitha janë nga Zoti ynë"! Por këtë e kuptojnë vetëm ata që janë të zotët e mendjes."*

Pjesëza 'dhe' (ar. و) mund të jetë për *ist'inaf* (vazhdim si pjesë e re e shkëputur, rifillim) apo si *atf*, që do të thotë se lidhet me pjesën paraprake. Kështu, fjala:

*...Dijetarët...'*

Është kryefjalë, ndërsa kallëzues është:

*...thonë: "Ne u kemi besuar atij...'*

Është thënë se pjesëza 'dhe' (ar. و) është pjesëz shtimi, që nënkupton se komentimin e ajeteve të paqarta e dinë dijetarët e zotë, por megjithëkëtë thonë se kemi besuar në to (shprehin modestinë e tyre)... <sup>25</sup>

Ajeti 2 nga kaptina el-Bekare:

*Ky është libri që nuk ka dyshim në të (sepse është prej All-llahut) është udhëzues për ata që janë të devotshëm."*

Përemri dëftor ' është në rasën emërore nga disa aspekte:

- 1) Si kallëzues i fjalës paraprake (ajetit 1 të kaptinës) 'الم *Elif lam mim'*;
- 2) Si kryefjalë, ndërsa fjala *el-kitab'* si kallëzues;

<sup>24</sup> Shih *Kesh-shafin* e Zemahsheriut dhe *Ruhul meani* të Bejdaviut për këtë ajet.

<sup>25</sup> Kthehu tek Tefsiri i Hazinit.

- 3) Si kryefjalë, ndërsa fjala '*el-kitab*' si ndajshtim cilësor (ar. *sifeh*) apo si zëvendësim (ar. *bedel*), ndërsa pjesa *që nuk ka dyshim në të* në pozitën e kallëzuesit;
- 4) Si kryefjalë, ndërsa '*udhëzues*' si kallëzues, ndërsa *nuk ka dyshim*' është në pozitën e rrethanorit të gjendjes (ar. *el-hal*), e në këtë rast regensi (ar. *amili*) i rrethanorit ka domethënien e dëftimit.
- 5) Që pjesa *nuk ka dyshim në të* (sepse është prej All-llahut) është *udhëzues*' të jetë kallëzues pas kallëzuesit.
- 6) Që kallëzuesi i tij të jetë kryefjalë e fshirë, e që paramendohet: ' هذا ذلك الكتاب *Ky është Ai libri...*'. ndërsa fjala '*udhëzues*' lejohet të jetë në pozitën emërore, përveç atij që përmendëm më parë, edhe nga tri aspekte të tjera, si:
  - a. që të jetë kallëzues i përemrit dëftor ,
  - b. që të jetë kallëzues i '*الم Elif lam mim*', kjo sipas mendimit të atyre që këtë e marrin si emër kaptine,
  - c. që të jetë kallëzues i kryefjalës së fshirë, e që paramendohet: '*هو هدى Ai është udhëzim.*'<sup>26</sup>

---

<sup>26</sup> Shih: Tefsiret e Tabresiut dhe Nesefiut.

## 5. LEXIMET E NDRYSHME

Disa fjalë kur'anore kanë më shumë se një formë leximi, dhe kjo varësisht nga transmetimet autentike të përcjella nga Pejgamberi Muhammed [*alejhis salatu ves selam*]. Dallimi në lexim ndonjëherë shkakton edhe domethënie të ndryshme, edhe pse sipërfaqësisht teksti nuk ndryshon. Kështu, nëse përkthyesi e përkthen vetëm sipas një leximi, atëherë domethënia tjetër do të anashkalohej.

Në vijim do të sjellim disa shembuj:

Ajeti 43 nga kaptina en-Nisa:

*“O ju që besuat, mos iu afroni namazit duke qenë të dehur, derisa të dini se ç'flitni, e as duke qenë xhuhubë (të papastër) derisa të laheni, përpos kur jeni udhëtarë. Nëse jeni të sëmurë, jeni në ndonjë udhëtim, ose ndonjëri prej jush vjen nga ultësira (nevojtorja), ose keni takuar gratë, e nuk gjeni ujë, atëherë mësyjeni dheun dhe fërkoni me të fytyrat dhe duart (tejemmum). All-llahu shlyen e fal mëkatet.”*

Hamza dhe Kesaiu, për dallim nga të gjithë lexuesit, fjalën' e kanë lexuar pa zgjatim<sup>27</sup>. Imam Shafiu, me leximin e parë, dëshmoi se prekja e prish abdesin, derisa Imam Ebu Hanife dëshmoi me leximin e dytë se nuk është për qëllim prekja e zakonshmja por kontakti intim, ndryshe prekja e rëndomtë nuk e prish abdesin<sup>28</sup>.

Ajeti 105 nga kaptina el-En'amë:

*“E kështu Ne i sqarojmë dëshmitë, ashtu që ata thonë: "Ke mësuar ti" (nga librat, po fjalës së tyre nuk i vihet veshi) dhe që për t'ia bërë edhe më të qarta një populli që di të dallojë (të vërtetën nga e kota).”*

Fjala 'Ke mësuar ti' është lexuar në shtatë forma:

1. Abu Amri dhe Ibni Kethiri e kanë lexuar: 'Daresté' (ar. دَارَسْتَ), e që ka kuptimin: I ke lexuar – studiuar Ithtarët e Librit dhe të kanë studiuar, i ke përkujtuar dhe të kanë përkujtuar.

<sup>27</sup> Dani, Ebu Amr, *et-Tejsiru fi-l-kiraati-s-seb'i*, f. 30.

<sup>28</sup> Shih tefsiret e Raziut, Bejdaviut dhe Ibni Kethirit.



2. Ibni Amiri dhe Ja'kubi e kanë lexuar: 'Dereset' (ar. دَرَسْتُ), e që ka kuptimin: ajo që ke sjellë ti është diç e skaduar, që njerëzit nuk e duan atë.
3. Nafiu, Asimi dhe Kesaiu<sup>29</sup> e kanë lexuar: 'Dereste' (siç figuron në tekst), e që ka kuptimin: ti ke mësuar dhe ke marrë mësim nga të tjerët.

Ajeti 6 nga kaptina el-Maide:

*“O ju që besuat! Kur doni të ngriheni për të falur namazin, lani fytyrat tuaja dhe duart tuaja deri në bërryla; fërkoni kokat tuaja, e këmbët lani deri në dy zogjtë...”*

Fjalën 'këmbët lani deri në dy zogjtë...', disa e kanë lexuar në rasën emërore e të tjerë në gjinore<sup>30</sup>. Dallimi në kuptim është shumë i madh. Ata që e lexojnë në emërore kanë për qëllim se larja e këmbëve është obligim derisa ata që e lexojnë në gjinore, mendojnë se kërkohet vetëm mes'hi i këmbëve (larja e pjeshme). Ajo që mendon shumica e dijetarëve është larja e këmbëve, pasi që është vërtetuar me praktikën e të Dërguarit të Allahut, Muhammedit [*alejhîs salatu ves selam*]<sup>31</sup>.

Ajeti 24 nga kaptina es-Sexhde:

*“Dhe prej tyre Ne bëmë prijës që me urdhrin Tonë udhëzojnë, pasi që ata (që i bëmë prijës) ishin të durueshëm dhe ndaj argumenteve Tona ishin të bindur.”*

Hamza dhe Kesaiu fjalën 'pasi që' e kanë lexuar në gjinore (لِما-), ndërsa të gjithë lexuesit e tjerë e kanë lexuar kështu siç figuron në tekst. Sipas leximit të parë, i bie se ata janë nderuar me këtë gradë për shkak të durimit të tyre, derisa sipas leximit të dytë, i bie që kur ata duruan, atëherë u shpërblyen me këtë gradë<sup>32</sup>.

<sup>29</sup> Shih tefsiret e Kurtubiut, Ebu Amr Daniut dhe *Kitabu-s-seb'ati* të Ibni Muxhahidit.

<sup>30</sup> Dani, Ebu Amr, *et-Tejsiru fi-l-kiraati-s-seb'i*, f. 98.

<sup>31</sup> Shih: *Ahkamu-l-Kur'an* të Xhessasit, tefsiret e Kurtubiut dhe Ebu-s-Suudit.

<sup>32</sup> Shih: *Kitabu-s-seb'ati* të Ibni Muxhahidit, tefsirin e Kurtubiut, librin *Kiraetlerin Tefsire Etkisi* të Abdurrahman Cetinit.

## 6. EKZISTIMI I NJË SËRË METODASH TË VEÇANTA VETËM PËR GJUHËN ARABE

1) Metoda e të kushtuarit vëmendje (ar. *Uslubu-l-iltifat*)

Është një metodë që bën ndërrimin e metodës së të folurit nga njëra metodë në tjetër, butësisht dhe me joshje për dëgjuesin, madje duke ia ripërtërirë potencialet, si dhe duke e kursyer nga monotonia dhe mërzitja vetëm me një metodë të foluri. Është metodë që përdoret shpesh në Kur'an por jo edhe në shumë gjuhë të botës. Për këtë shkak, ndodh që përkthyesi, duke qenë se nuk ka metodë të tillë në gjuhën e tij, ta anashkalojë këtë aspekt shumë të rëndësishëm gjatë përkthimit të tij.

Kjo metodë ka lloje të ndryshme, si:

a) Kthimi nga fjalimi në vetë të tretë (ar. *el-iltifatu minel hitabi ilet gajbeti*)

I kësaj natyre është ajeti 22 nga kaptina Junus:

*"...deri kur jeni në anije që lundrojnë me ta (me udhëtarët) me anë të një ere të lehtë..."*

Siç mund të shohim në ajet, derisa biseda zhvillohej në mes palëve të pranishme, bëhet zhvendosja në dikë që nuk është fare i pranishëm. Urtësia e kësaj zhvendosjeje të bisedës, duke ua treguar gjendjen e tyre të tjerëve, është bërë për shkak të çuditjes me veprimin dhe femohimin (kufrin) e tyre. Ndryshe, sikur biseda të vazhdonte të zhvillohej vetëm në relacionin e sipërpërmendur, atëherë kjo urtësi do të ikte.

Është thënë edhe ndryshe. Biseda në fillim përfshinte njerëzit në përgjithësi, besimtarët e jobesimtarët, për të ndryshuar më pas rrjedhën e bisedës ku përfshihen vetëm ata që qortohen për veprimet e tyre. Pra, është ndërruar kahja e bisedës nga e përgjithshmja tek qortimi vetëm i një pjese, të përshkruar me detajet e dhëna në ajet...<sup>33</sup>

b) Kthimi nga biseda si vetë e tretë në vetë të parë (ar. *el-iltifatu minel gajbeti ie-t-tekel-lumi*)

I kësaj natyre është ajeti 9 nga kaptina Fatir:

---

<sup>33</sup> Zerkeshiu, *el-Burhan*, 3/318.

*“All-llahu është Ai që i lëshon erërat, e ato i lëkundin retë dhe Ne i derdhim ato në një vend të thatë...”*

Urtësia në këtë ajet qëndron në atë se përderisa askush nuk ka mundësi të sjellë retë për ta lëshuar shiun me të cilin ngjallet jeta në tokë, pra është një argument i fuqisë dhe madhësisë së Allahut, atëherë për ta demonstruar atë më mirë dhe për të treguar se me të shquhet vetëm Ai, kalon në këtë formë nga veta e tretë në vetën e parë<sup>34</sup>.

I këtillë është edhe ajeti i parë nga kaptina el-Isra:

*“Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabes) gjer në Mesxhidi Aksa (Bejti Mukaddes), rrethinën e të cilës Ne e kemi bekuar, (ia bëmë këtë udhëtim) për t'ia treguar atij disa nga argumentet Tona. Vërtet, Ai është dëgjuesi (i fjalëve të Muhammedit), pamësi (i punëve të Muhammedit).”*

Zemahsheriu ka thënë: Urtësia në këtë ajet dhe ajete të ngjashme është tërheqja e vëmendjes se me këtë fuqi shquhet vetëm Allahu dhe askush tjetër...<sup>35</sup>

c) Kthimi nga bisedimi në fjalim (ar. *el-iltifatu mine-t-tekellumi ile-l-hitab*)

Kjo bëhet kur folësi synon ta nxisë dëgjuesin (audiencën) për të qenë i vëmendshëm për atë që flet. I këtillë është ajeti 22 nga kaptina Jasin:

*“E, ç'kam unë që të mos e adhuroj atë që më krijoi dhe tek Ai ktheheni.”*

Sic mund të vërejmë, fjalimi është nxjerrë nga konteksti individual, ngase me të është synuar këshillimi i popullit. Kjo, në fakt, është një metodë e shkëlqyer edukimi, ngase folësi sikur dëshiron t'iu thotë se për ju dua atë që dua për vete. Po kështu, këtë e bën për shkak të pozitës si thirrës, për çka i frikëson (sikur që i nxit herëve të tjera). E gjithësesi se në këtë fshihet dhe gjendja e audiencës, të cilët duke qenë se e mohonin adhurimin, frikësoheshin me këtë se do t'i kthehen Allahut, i Cili ka për t'i gjykuar<sup>36</sup>.

d) Shprehja e së ardhmes me fjalët e së kaluarës dhe anasjelltas

Kjo ndodh në ato raste kur kuptimi i veprës ka të bëjë me gjërat e rrezikshme, me ato për të cilat parashihet dënim, për çka shprehet me

<sup>34</sup> Zerkeshiu, *el-Burhan*, 3/319-320.

<sup>35</sup> Sujuti, *el-Itkan*, 2/110.

<sup>36</sup> Zerkeshiu, *el-Burhan*, 3/315.

shprehje të së kaluarës për shkak të ndodhjes në praktikë të një gjëje të tillë. I këtillë është ajeti 87 nga kaptina en-Neml:

*“(përkujto) Ditën kur i fryhet surit, e të frikësohet kush është në tokë, përpos kë do All-llahu (të mos frikësohet) dhe t'i vinë Atij të gjithë të përulur.”<sup>37</sup>*

Shumë përkthyes, nga frika e keqkuptimeve në gjuhën e tyre, këtë fjalë e përkthejnë jo siç ka ardhur në kohën e kaluar por në të tashmen.

2) Metoda e përparësimit dhe zvarritjes së gjymtyrëve të fjalisë (ar. *uslubu-t-takdimi ve-t-te'hir*)

Është një metodë e retorikës që flet edhe për madhështinë e gjuhës arabe. Ndonjëherë përparësimi i gjymtyrëve të fjalisë bëhet për shkak të çudisë me gjendjen e të përmendurit. I këtillë është rasti kur përparësohet kundrinori i dytë ndaj të parit, siç është p.sh. në ajetin 100 të kaptinës el-En'amë:

*“E xhinët ia bëjnë shokë All-llahut...”*

Sipas rregullave, do të duhej përmendur *'el-xhinne shurekae'*, por është përparësuar fjala *'shurekae'* ngase për qëllim është qortimi dhe përparësimi është shumë më domethënës në këtë kontekst qortimi.<sup>38</sup>

3) Metoda e krahasimit dhe ngjashmërisë (ar. *uslubu-l-mukabeleti ve-l-mushakeleti*)

Kjo ndodh kur përmend diç me shprehje të huaja për shkak se kjo e fundit ndodh (është e pranishme) tek i pari, qoftë si realitet qoftë si paramendim<sup>39</sup>. P.sh. i këtillë është ajeti 116 nga kaptina el-Maide:

*“... Ti e di ç'ka ka në mua, e unë nuk di ç'ka ka në Ty. Ti je më i dijshti i të fshehtave!”*

Fjala *'nefs'* (mua...Ty), e përmendur nga Isai [*alejhis selam*] ka të bëjë vetëm për shkak të ngjashmërisë në emërtim (ar. *nefsi, nefsike* – mua, Ty).

Me këtë kuptim është edhe ajeti 14 nga kaptina el-Bekare:

---

<sup>37</sup> Sujuti, *el-Itkan*, 3/373.

<sup>38</sup> Zerkeshiu, *el-Burhan*, 3/236.

<sup>39</sup> Shih tefsirin e Kurtubiut.

*"E kur i takojnë ata që besuan thonë: "Ne kemi besuar!" Por kur veçohen me djajtë (parinë) e vet u thonë: "Ne jemi me ju, ne vetëm jemi tallur (me besimtarët)."*

Nesefiu ka thënë: Allahu tallet me ta, d.m.th. i shpërblen me të keq për talljen e tyre. Pra, shpërblimi i talljes është quajtur me emrin e veprës – talljes. Me këtë kuptim kanë ardhur edhe ajete të tjera (shih: esh-Shura, 40; el-Bekare, 194.), ku për veprën e keqe përmendet ndëshkimi me emër të vetë veprës<sup>40</sup>.

4) Metoda e krijimit të iluzionit (ar. *el-iham* apo *et-teurijeh*)

Kjo bëhet kur përmendet një fjalë që ka dy kuptime, por që dëgjuesi krijon përshtypjen se bëhet fjalë për atë që ai e kupton në shikim të parë. P.sh. ajeti 95 nga kaptina Jusuf:

*Ata (që ishin prezent) thanë: "Për All-llahun, ti vërtet qëmoti je në humbje."*

'Humbja' nënkupton dashurinë dhe të kundërtën e udhëzimit, dhe bijtë e Ja'kubit [*alejhis selam*] e përdorën me kuptimin e dashurisë e jo humbjes<sup>41</sup>, siç mund ta keqkuptojë nga teksti sipërfaqësor lexuesi.

Kështu është komentuar edhe ajeti 54 nga kaptina Ali Imran:

*E, ata (jehuditë) i kurdisën një dredhi (mbytjen e Isait), All-llahu iu kundërvu dredhisë së tyre, All-llahu është asgjësuesi më i fuqishëm kundër atyre që bëjnë dredhi."*

Allahu nuk mashtron, larg asaj, i pastër nga të metat është Ai, por i shpërblen (lexo: ndëshkon), siç sqaruar edhe në pikën paraprake, me llojin e veprës së tyre. Ata mashtrojnë ndërsa Allahu ua shkatërron mashtrimet dhe kurthet e tyre<sup>42</sup>.

---

<sup>40</sup> Sujuti, *el-Itkan*, 2/120.

<sup>41</sup> Sujuti, *el-Itkan*, 2/107-108.

<sup>42</sup> Bejdavi, *Envaru-t-Tenzil*, ajeti përkatës.

## 7. KUR PËRKTHYESI NUK E KA TË QARTË LIDHSHMËRINË NDËRMJET AJETEVE

Retorika arabe shquhet për përmbledhshmëri (ar. *i'xhaz*). E duke qenë se Kur'ani është maja e retorikës arabe, sigurisht se shquhet dhe për *i'xhaz*. Për këtë shkak, gjërat që lexuesi i zgjuar mund t'i kuptojë nga konteksti, nuk i përmend fare. Kjo, në rast të përkthimit në gjuhë të tjera, mund të krijojë tek lexuesi joarab ndjenjën e paqartësisë dhe konfuzionit, sikur nuk ekziston lirshmëri tematike ndërmjet ajeteve dhe kaptinave kur'anore. Andaj, është porosi për përkthyesin që të shtojë dhe fjalë nga komentimet e Kur'anit, në mënyrë që përkthimi i tij të dalë komplet.

Kur'ani ka qindra shembuj të kësaj natyre. Të marrim si shembull kaptinën en-Neml, ajetet 5 - 11. Thotë Allahu i Madhëruar:

*"Të tillët janë ata që u takon dënimi më i rëndë dhe mu ata do të jenë më të dëshpëruarit në botën tjetër. 6. E s'ka dyshim se ti (Muhammed) e pranon Kur'anin nga i Urti, i Dijshmi. 7. (Përkujto) Kur Musai i tha familjes së vet: "Unë e pash një zjarr, e nga ai do t'ju sjell ndonjë lajm ose do t'ju sjell një urë të ndezur që të ngrohni". 8. E kur arriti tek ai u thirr: "I bekuar është ai pranë zjarrit dhe ata përreth tij. I veçuar në madhëri është All-llahu, Zot i botëve! 9. O Musa, në të vërtetë Unë jam All-llahu, i plotfuqishmi, i urti. 10. E ti hidhe shkopin tënd! E kur e pa atë që lëvizte si të ishte gjarpër, ai (nga frika) ktheu prapa duke mos pasur më kujdes. (I thamë) O Musa! Mos u frikëso se pranë meje të dërguarit nuk frikësohen! 11. Përpos kush (nuk është i dërguar) bën mëkat (ai frikësohet) e që të keqen pastaj e zëvendëson me të mirën, atëherë s'ka dyshim se Unë jam që fal shumë dhe jam mëshirues."*



Lidhjen e ajetit 5 dhe 6, në mënyrë që të mos keqkuptohet se edhe i Dërguari është në mesin e të përmendurve, duhet ta bëjë me 'ndërsa ti' (ar. *fe emma ente*). Metodologjia kur'anore na befason në ajetin vijues (7), në të cilin përmendet rrëfimi për Musanë [*alejhis selam*], andaj, për përkthyesin preferohet që me këtë rast të shtojë: 'Shembulli i Musasë, i cili ka qenë nga të Dërguarit, dhe i cili i tha familjes...', në mënyrë që lexuesi të mund ta lidhë të folurit e mëparshëm me këtë vijues.

Në vazhdim të rrëfimit për Musanë [*alejhis selam*], gjegjësisht në ajetin 10 e tutje, vjen një lloj përjashtimi në vazhdimësi të të folurit (ar. *istithnaun fi devamil kelam*). Shumë përkthyes konsiderojnë se ky përjashtim është i llojit të lidhur (ar. *istithnaun muttesil*), që do të thotë se një grup peygamberësh i bëjnë vetes padrejtësi, ndërsa në fakt, përjashtimi është i shkëputur (ar. *istithnaun munkatiun*). Ajeti do të duhej të përkthej kështu:

*'O Musa, mos ki frikë ngase të Dërguarit nuk frikësohen tek Unë. Ata që duhet të frikësohen prej Meje janë ata që i kanë bërë vetes padrejtësi, por, megjithëkëtë, nëse ata ndryshojnë për të mirë, Unë ua fal mëkatet dhe i mëshiroj!'*

Ja dhe një shembull tjetër nga kaptina en-Nahl, ajeti 71:

***All-llahu favorizoi disa prej jush mbi disa të tjerë në furnizim. Atyre që u është dhënë përparësia (në furnizim), nuk janë furnizues të atyre që posedojnë (robërve), ata (të gjithë) në të janë të barabartë (furnizues kryesor është All-llahu), a mos duan të mohojnë dhuntinë e All-llahut?'***

Disa përkthyes turq e kanë përkthyer me këtë domethënie: 'Disa pasanikë të favorizuar nuk ushqejnë robërit dhe shërbëtorët që janë në pronësi të tyre, ndërsa ata që të gjithë janë të njëjtë në furnizim...' <sup>43</sup>

Për shkak të këtyre përkthimeve, disa këtë ajet e kanë marrë si bazë për idenë socialiste. Përkthimi është bërë gabim, për shkak se pjesëza 'أ' (f) në pjesën e ajetit:

***"...ata (të gjithë) në të janë të barabartë (furnizues kryesor është All-llahu)..."***

...është shkakore (ar. *sebebijeh*)<sup>44</sup>. Kështu, përkthimi do të duhej të ishte: 'Të pasurit që Allahu i begatoi me lloje të ndryshme të mirësive, pasuritë e tyre nuk ua japin atyre që i kanë në pronësi dhe shfrytëzim për shkak të mos rënies në nivel të

---

<sup>43</sup> Shih përkthimin e bërë nga Kryesia e Çështjeve Fetare, dhe tefsirin e Muhammed Vehbiut 'Hulasatu-l-bejan.'

<sup>44</sup> Shih tefsiret e Kurtubiut dhe Hazinit.

tyre.' Pra, sikur gërditen dhe neveriten nga kjo, ngase dhënia do t'i barazonte në pozita.

Ky përkthim duket më i qëlluar për faktin se ajeti bën fjalë për figura idhujtare, të cilët refuzonin t'iu ndihmonin robërve dhe shërbëtorëve, edhe pse ishin njerëz. A nuk ishin të dyja palët të barabartë në këtë aspekt?! E nëse është ky gjykimi i tyre, atëherë si kanë të drejtë të kërkojnë nga Allahu që të lëshojë pe në të drejtën e adhurimit dhe këto attribute t'ua falë idhujve, atyre gurëve të heshtur...?!

Ajeti 58 nga kaptina en-Nur:

*"O ju të cilët besuat, ata të cilët i keni në pronësinë tuaj (shërbëtorët) dhe ata që nuk kanë arritur moshën e pjekurisë, duhet të kërkojnë leje prej jush (për të hyrë te ju) në tri kohë: para namazit të sabahut, në kohën e drekës kur i hiqni rrobat tuaja (për të pushuar) dhe pas namazit të jacisë, që të tria këto kohë janë kur ju nuk jeni të veshur..."*

Disa e kanë keqkuptuar shifrën në këtë ajet, duke menduar se ajo flet për kërkimin e lejes tri herë, ndërsa fjala është për tri kohë të lejuara. Pra është në pyetje koha e jo shifra.

Disa përkthime lidhen edhe me gabime të rënda, qofshin këto të natyrës së drejtimit, lëvizjes apo bindjeve. P.sh. një nga përkthyesit duke përkthyer ajetin 102 të kaptinës el-Bekare:

*(E hodhën librin e Zotit) E ndoqën atë që e thoshin djajtë në kohën e sundimit të Sulejmanit. Po Sulejmani nuk ishte i pafé, djajtë ishin të pafé, sepse u mësonin njerëzve magjinë. (ndoqën) Edhe çka u zbriti në Babil dy engjëjve, Harutit dhe Marutit. E ata të dy nuk i mësonin askujt (magjinë) para se t'i thoshin: "Ne jemi vetëm sprovë, pra mos u bën i pa fé!"..."*

Përkthyesi, me gjasë nuk e ka besuar sihrin (magjinë), andaj edhe pjesën ' në pjesën e ajetit:

*E ata të dy nuk i mësonin askujt (magjinë) para se t'i thoshin: "Ne jemi vetëm sprovë, pra mos u bën i pa fé!"*

...që është përemër lidhor, e ka përkthyer si pjesëz mohuese<sup>45</sup>. Kjo logjikisht dhe gjuhësisht është e papranueshme. Si mund të thuhet se nuk iu kanë zbritur melekët atyre ndërsa këtu flitet edhe për proces mësimi (pra ua kanë mësuar magjinë)...?!

---

<sup>45</sup> Shih përkthimin e bërë nga Kryesia e Çështjeve Fetare.

## Përfundim

*Lexues i nderuar!*

Kjo ishte një përmbledhje e disa prej shkaqeve që paraqesin probleme serioze në përkthimin e domethënies të Kur'anit. Dijetarët janë kompaktë sa i përket asaj se përkthimi fjalë për fjalë i Kur'anit, për shkaqet që përmendëm sipër por edhe për të tjera, ndalohej. Ndërsa përkthimi me komentim, edhe pse në fakt nuk sjell ato botëkuptimet origjinale, për hir të kumtimit të fesë tek njerëzit, është i lejuar. Ndryshe, ne jo vetëm që do t'i privonim joarabfolësit nga libri i tyre i shenjtë, porse do t'i shërbenim shumë edhe qëllimeve të ulëta të vendeve joislame, më saktësisht vendeve imperialiste, të cilat kur kolonizuan vendet islame, dëshironin t'ua pamundësonin njerëzve kontaktet me librin e tyre, andaj edhe ngritën një moto: *'Kur'ani është një libër i shenjtë, që ka prekur majat e retorikës, kështu që përkthimi i tij në gjuhët e tjera është i pamundur!'*<sup>46</sup>

Pra, njerëzve duhet t'ua ofrojmë domethëniet e Kur'anit, por kurrë me bindjen se ato janë vetë Kur'ani në origjinal. Përkthimi, në çfarëdo gjuhe, nuk quhet Kur'an. Nuk lejohet leximi i përkthimit në namaz dhe as që të nxirren dispozitat prej përkthimit. Kjo nuk nënkupton se ne thërrasim në braktisjen e përkthimeve. Larg asaj! Ne nxisim për leximin dhe për përfitimin prej tyre, por me kusht që këto përkthime të jenë kryer nga ekspertë dhe profesionistë. Leximi i përkthimit të Kur'anit shpërblehet.

Allahu e di të vërtetën më së miri!

---

<sup>46</sup> Shih: Bundak, Muhammed Salih, *el-Musteshrikune ve terxhemetu-l-Kur'ani-l-Kerim*, f. 71-72.

## Bibliografi

1. Abd-l-Baki, Muhammed Fuad, *el-Mu'xhemu-l-mufehresu li elfadhi-l-Kur'ani-l-Kerim*, Stamboll, 1982.
2. Akdemir, Salih, *Kiraetlerin Tefsire Etkisi*, Bursa, 1996.
3. Alusi, *Ruhu-l-meani*, Egjipt, 1302 h.
4. Aydar, Hidayet, *Kur'ani Kerimin Tercumesi Meselesi*, Stamboll, 1996.
5. Aydin, Ferit, *Tercume Sanatinin Gercekleri*, Stamboll, 1984.
6. Bejdavi, *Envaru-t-Tenzil*.
7. Dani, Ebu Amr, *et-Tejsir fi-l-kiraati-s-seb'ë*, Stamboll, 1930.
8. Dehlevi, Shah Velijullah, *el-Feuzul kebir fi usuli-t-tefsir*, përkthim në arabisht nga Selman Nedevi, 1984.
9. Dhehebi, Muhammed Husejn, *et-Tefsir ve-l-mufessirune*, Kajro, 1976.
10. Ebu Zehre, Muhammed, *el-Mu'xhizetu-l-Kubra - el-Kur'an*, Kajro, 1970.
11. Ebu-s-Suud, *Irshadu-l-akli-s-selim*, Bejrut.
12. *El-Musteshkrikune ve terxhemetu-l-Kur'ani-l-Kerim*, Bejrut, 1980.
13. Gazali, *el-Mustasfa min Ilmi-l-Usul*, Kajro, 1980.
14. *Haule terxhemetina li meani-l-Kur'ani-l-Kerim*, Dr. Suat Yildirim, revista Yeni Umit, nr. 43, shkurt, 1999, Stamboll.
15. Ibni Ashur, Tahir, *Tefsiru-t-tahrir ve-t-tenviri*, Tunis, 1984.
16. Ibni Haxher, *Fet'hu-l-Bari*, Kajro, 1978.
17. Ibni Kethir, *Tefsiru-l-Kur'ani-l-Adhim*, Stamboll, 1984.
18. Ibni Muxhahid, *Kitabu-s-seb'ati fi-l-kiraat*, Kajro, 1984.
19. Ibnul Hatib, Muhammed Abdu-l-Latif, *el-Furkan*, Bejrut.
20. Kattan, Mennaë, *Mebahith fi ulumi-l-Kur'an*, Rijad, 1981.
21. Kurtubi, *el-Xhamiu li ahkami-l-Kur'an*, Bejrut, 1965.
22. Menahil el-urfan fi ulumi-l-Kur'an, Kajro, 1943.
23. Neseфи, Ebu-l-Berekat, *Medariku-t-Tenzil*, Stamboll, 1984.
24. Përkthimi i domethënieve të Kur'anit në gjuhën turke, Ankara, Cumhuriyet Donemi Kur'an Tercumeleri.
25. Përkthimi i domethënieve të Kur'anit në gjuhën turke, Diyanet Isleri Baskanligi, 1975.
26. Përkthimi i domethënieve të Kur'anit në gjuhën turke, Dr. Suad Yildirim, Stamboll, 1997.
27. Përkthimi i domethënieve të Kur'anit në gjuhën turke, Dr. Suleyman Ates, Ankara, 1977.

28. Përkthimi i domethënieve të Kur'anit në gjuhën turke, Hasan Basri Hantay, Stamboll, 1984.
29. Rrazi, Faruddin, *Mefatihul-gajb*, Bejrut.
30. Sabri, Mustafa, *Mes'eletu terxhemeti-l-Kur'an*, Kajro, 1351 h.
31. Salih, Subhi, *Mebahith fi ulumi-l-Kur'an*, Bejrut, 1968.
32. Seid Nursi, Bediu-z-zeman, *el-Kelimat*, Stamboll, 1992.
33. Serhasi, *el-Mebsut*, 1983.
34. Sujuti, *el-Itkan fi ulumi-l-Kur'an*, Kajro, 1951.
35. Shatibiu, *el-Muwafekat*, Kajro.
36. Taberi, *Xhamiu-l-bejan an te'vili aji-l-Kur'an*, Kajro, 1954.
37. Tabrisi, *Mexhmeu-l-bejan*, Bejrut, 1986.
38. Tefsiru-l-Hazin, Stamboll, 1984.
39. *Tenviru-l-mikbas min tefsiri Ibni Abbas*, Stamboll, 1984.
40. Xhessasi, *Ahkamu-l- Kur'an*, Stamboll, 1335 h.
41. Zemahsheriu, *el-Kesh-shaf*, Kajro, 1977.
42. Zerkeshiu, *el-Burhan fi ulumi-l-Kur'an*, Kajro, 1957.